

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi, Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Përparim Zeka procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.A. nga Vitia, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit F.A., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.199/2017 datë 28.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 12.03.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit F.A., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.199/2017 datë 28.12.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.199/2017 datë 28.12.2017, të akuzuarin F.A. e ka shpallur fajtorë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke i shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro të cilin dënim i akuzuari obligohet që ta paguaj në afat prej 2 muajve nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse i akuzuari refuzon ta paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme ashtu që për 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të barazohen me 20 euro të dënimit me gjobë. Nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë zëvendësohet me dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 euro të dënimit me gjobë do të caktohet një ditë burgim. Të akuzuarit F.A. i shqiptohet dënimi plotësues – konfiskimi i pushkës automatike AK47 me numër serik 032079-86, kalibri 7.62 mm si dhe 2 karikatorë. Detyrohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita pasi ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

- Mbrojtësi i të akuzuarit F.A., av. B.H., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj si të bazuar ankesën, aktgjykimin e shkallës së parë ta prishë sa i përket vendimit mbi dënim ashtu që të akuzuarit F.A. ti shqiptohet një dënim me i butë.

- Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.76/2018 të dt. 28.02.2018 ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit F.A., av. B.H. të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e pa bazuara.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit F.A. lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa është e pa bazuar. Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që kishte me ndikuar në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit. Mbrojtësi e të akuzuarit konsideron se gjykata e shkallës së parë nuk e ka përcaktuar drejtë lartësinë e dënimit të gjobës sepse i njëjti nuk është në marrëdhënie pune ashtu siç është përshkruar në aktgjykim se i njëjti është pronar i kafiteris “NN” sepse i njëjti nuk është pronarë i kësaj kafiterie ashtu siç ka deklaruar në seancën gjyqësore - shqyrtim fillestar dhe se i njëjti në mënyrë vullnetare ka bashkëpunuar dhe ka pranuar veprën penale në prokurori por edhe në gjykatë. Mirëpo Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese që i ka konstatuar dhe vlerësuar drejtë gjykata e shkallës së parë si: pranimin e fajësisë, ka pasur sjellje të mira gjatë të gjitha fazave të procedurës penale, se është i martuar, baba i dy fëmijëve, se arma ishte pa municion dhe i njëjti e kishte dorëzuar vullnetarisht armën, se është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale dhe se i njëjti ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale dhe se nuk kanë gjetur rrethana rënduese, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.75/18, më 12.03.2018

Procesmbajtës,
Përparim Zeka

Kryetare e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Have Haliti _____